



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0061

Nr. 2026/0067

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Standard Home Furniture” L.L.C. dhe ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Fatmir Godeni” B.I.lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim (kornizë) me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës (Ri-tenderim I dyte)”, me numër të prokurimit: 207-25-936-1-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe CJK, me datën 23.03.2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohen**, si pjesërisht të bazuara ankesa e Operatorit Ekonomik “Standard Home Furniture” L.L.C. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 26.01.2026 me numër protokoll 2026/0061, si dhe ankesa e Operatorit Ekonomik “Fatmir Godeni” B.I.e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 27.01.2026 me numër protokoll 2026/0067, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim (kornizë) me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës (Ri-tenderim I dyte)” me nr. të prokurimit 207-25-936-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe CJK.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në pikën 1 të këtij dispozitivi.
3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesave dhe obligohet OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.02.2025, Ministria e Kultures RS dhe CJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim (kornizë) me rekuizita dhe pajisje sportive per institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale ne Republiken e Kosoves (Ri-tenderim I dyte)” me numër të prokurimit: 207-25-936-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,000,000.00 €.

Me 15.01.2026 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 19.01.2026, OE “Standard Home Furniture” L.L.C. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me date 19.01.2026 po ashtu edhe OE “Fatmir Godeni” B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 22.01.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 26/01/2026, OE “Standard Home Furniture” L.L.C. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0061/26.

Ndërsa me datë 27/01/2026 OE “Fatmir Godeni” B.I. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0067/26.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0061/26 dhe ankesa nr. 0067/26 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Standard Home Furniture” L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1:

Kundër arsyetimit të eliminimit të kompanisë sonë dhe kundër anulimit tërësor të procesit të prokurimit, ne si OE, me datën 19.01.2026, kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim, ku në të njëjtën kërkesë kanë qenë të përfshira gjithsej 4 pretendime ankimore me fakte, me prova dhe me bazë ligjore. Pavarësisht kësaj, AK – MKRS, zyrtarët përgjegjës të Zyrës së Prokurimit, me datën 22.01.2026, nxjerrin vendim dhe refuzojnë kërkesën tonë pa e trajtuar asnjë pretendim të vetëm ankimor, duke përbuzur shkeljet dhe abuzimin me procedurën e prokurimit.

Sipas nenit 108/A të LPP-së, paragrafi 9 dhe 10, AK është e obliguar t'i trajtojë të gjitha pretendimet ankimore të përfshira në kërkesën për rishqyrtim, ndërsa AK ka nxjerrë një vendim “copy-paste”, duke u marrë vetëm me katalogun, por ka heshtur plotësisht ndaj pretendimeve tona lidhur me zvarritje të qëllimshme dhe shkelje të nenit 44 të LPP-së; ka heshtur lidhur me pretendimin ankimor për shkelje të nenit 26.4 të Rregullores nr. 001/2022, për detyrimin për të kërkuar vazhdimin e validitetit, si dhe për pretendimin ankimor për legjitimitimin e palëve të papërgjegjshme.

Sipas nenit 108/A, AK – MKRS është e obliguar të japë arsyetim për secilin pretendim dhe mos-trajtimi i tyre e bën vendimin e AK-së të cenueshëm dhe të paligjshëm në procedurë.

Në faqen 4 të vendimit, tek arsyetimi i vendimit të AK – MKRS, është shkruar fjalia kryesore: “AK refuzon ofertën pa kërkuar sqarime shtesë”.

Kjo fjali do të duhej të ishte dëshmia kryesore për OSHP-në, ku AK vetë e pranon se ka pasur dyshime për përputhshmërinë katalog–certifikatë apo për markën CASAL, por ka shkelur detyrimin ligjor për të kërkuar sqarime shtesë. Praktika e OSHP-së është e qartë: AK nuk mund të eliminojë një OE për paqartësi dokumentesh pa aplikuar fillimisht nenin 59.4 dhe nenin 72 të LPP-së.

Pra, fakti që ky është “ritenderimi i dytë” vërteton se AK është e paaftë të realizojë procesin dhe ka qëllime të caktuara për lidhjen e kontratës me kompani të caktuara, të cilën e ka rekomanduar në tri procedura për të cilat ekzistojnë prova dhe fakte. Për shkak të vlerësimeve arbitrare, AK po mban peng rekuizitat sportive të nxënësve tash e më shumë se 3 vite, duke insistuar të lidhë kontratë me kompani të papërgjegjshme në secilën pikëpamje, dhe OSHP, ligjërisht, duhet të ndërhyjë për të mbrojtur interesin publik dhe buxhetin e shtetit nga tentativa e radhës dhe e tretë.

Pretendimi ankimor 2:

AK – MKRS, komisioni i ri i vlerësimit të ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit, me arsyet e përshkruara në letër standarde ndaj ofertës sonë, përveç se kanë konsumuar shkelje esenciale të dispozitave ligjore për prokurim publik, kanë konsumuar edhe vepër penale e cila është e sanksionuar me nenin 414 dhe 415 të KPRK-së.

Kanë keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar dhe kanë keqpërdorur dhe mashtruar përmes procedurës së prokurimit dhe për këto veprime detyrimisht do të kërkohet përgjegjësi në Prokurorinë Speciale të Kosovës.

Lidhur me arsyetimin e eliminimit ndaj ofertës sonë, se dokumentet – certifikatat e dorëzuara nuk vërtetojnë specifikacionet teknike të kërkuara për rekuizitat sportive, gjegjësisht për mos-përmblidhjen e kërkesave 1.1 – 10.1 të FDT-së, janë krejtësisht kundërligjore, pasi AK – MKRS

askund në kërkesën kualifikuese nuk ka kërkuar që këto certifikata duhet të jenë valide apo diçka të tillë.

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nga pika 1.1 deri tek pika 1.10, AK – MKRS ka kërkuar që të dorëzohet dokumentacioni për produktin, përkatësisht për secilin kapitull veç e veç.

Pra, mungesa e kërkesës për validitet në Dosjen e Tenderit për pikat nga 1.1 deri në 1.10, që përfshijnë topat e basketbollit, futbollit, volejbollit, hendbollit dhe rekuizitat tjera – ku Autoriteti Kontraktues ka kërkuar certifikata të cilësisë si FIBA, FIFA, IHF, etj. – tregon se në Dosjen e Tenderit nuk është specifikuar asnjë kriter apo kërkesë që këto certifikata të jenë apo të mbeten valide deri në një datë të caktuar pas dorëzimit të ofertës.

Çdo eliminim i bazuar në skadimin e certifikatave gjatë kohës që AK – MKRS e ka zvarritur vlerësimin për muaj të tërë, çon në vendosje të kriterëve të reja dhe deponim të lëndës në krime ekonomike dhe në Prokurorinë Speciale, gjë që neve si kompani na detyron që të gjithë këtë proces prokurimi ta deponojmë në instanca të tilla, pasi të gjitha këto veprime dhe mosveprime janë tipike kundërligjore dhe zyrtarët përgjegjës duhet të merren në përgjegjësi ligjore.

AK – MKRS do duhej të ishte e vetëdijshme se produktet sportive të kërkuara në pikat 1.1 – 1.10 janë mallra që pësojnë përditësime të vazhdueshme specifike dhe teknike. Prodhuesit globalë nxjerrin certifikata të reja në baza mujore apo vjetore për të shoqëruar modelet e avancuara të produkteve të tyre, dhe AK – MKRS, që nga data e publikimit të njoftimit për kontratë deri më datën e publikimit të njoftimit dhe tentativës për anulim të procedurës, në më shumë se një vit vetëm për këtë procedurë prokurimi, me një arsyetim të tillë eliminimi, nuk do duhej t'i amnistonte në asnjë rrethanë, pasi certifikata e pakërkuar si kërkesë kualifikuese mund të ketë skaduar gjatë zvarritjes procedurale të AK – MKRS-së, ndërsa në realitet është zëvendësuar me një certifikatë të re përditësuese nga prodhuesi.

Pra, AK – MKRS, sipas nenit 59.4 dhe nenit 72 të LPP-së, ka pasur detyrim ligjor që të kërkojë sqarime plotësuese për të na mundur dorëzimin e certifikatave të përditësuara dhe me validitet, e jo ta përdorë këtë formalitet si mjet për eliminim arbitrar të ofertës sonë, ani pse në vlerësimin paraprak ofertën tonë e ka rekomanduar për dhënie të kontratës.

Çështjet e interesave personale në institucionin e AK – MKRS tani më janë të njohura dhe janë shfaqur edhe në OSHP. Gjegjësisht, paneli shqyrtues i prokurimit, bazuar në ligjin në fuqi, këtë lëndë do duhej ta depononte në MPB dhe zyrtarisht të kërkonte inicimin e hetimit për krim të organizuar.

Pretendimi ankimor 3:

Autoriteti Kontraktues – MKRS, jo vetëm në këtë rast të rivlerësimit të ofertave, ka tejkaluar çdo afat ligjor të mundshëm për vlerësimin dhe rivlerësimin e ofertave.

Sipas nenit 44 të LPP-së, periudha e vlefshmërisë së ofertës është e limituar, ndërsa neni 59 kërkon një proces vlerësimi të shpejtë dhe efikas, jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave, bazuar edhe në nenin 40 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Zvarritja prej më shumë se 6 muajsh në këtë aktivitet prokurimi nuk është pasojë e kompleksitetit, por mjet i përdorur qëllimisht për të shkaktuar skadimin e validitetit të ofertave dhe sigurimeve të tenderit të kompanisë sonë, si fituese dhe e rekomanduar në vlerësimin paraprak.

Ky anulim i procedurës do duhej të mbetej në tentativë, si i jashtëligjshëm përmes pasivitetit të qëllimshëm të zyrtarëve përkatës dhe përgjegjës të AK-së, krejt kjo me qëllim të dhënies së mundësisë për lidhjen e kontratës me kompaninë të cilën në vlerësimin fillestar e ka rekomanduar në tri procedurat paraprake dhe me të cilën po tentohet të lidhet kontratë tash e më shumë se 3 vite. AK – MKRS do duhej ta kishte parasysh se oferta e papërgjegjshme nuk mund të bëhet në asnjë rrethanë e përgjegjshme dhe nuk mund të shkaktohen pasoja të tilla për qëllime personale. Ne nuk mund dhe nuk do ta tolerojmë abuzimin me paranë publike dhe një gjë e tillë do duhej të merrej parasysh edhe me rastin e shqyrtimit të ankesës dhe të lëndës në përgjithësi nga OSHP.

Neni 40.3 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik qartë përcakton:

“AK është e obliguar që vlerësimin ta përfundojë brenda afatit maksimal prej 30 ditëve ose 45 në raste jashtëzakonisht komplekse”.

Çdo ditë vonesë pas këtij afati, pa një arsyetim objektiv dhe pa njoftim të KRPP-së, përbën shkelje administrative dhe cenon parimin e efikasitetit. AK – MKRS dhe asnjë AK tjetër, ligjërisht dhe madje as logjikisht, nuk mund të përdorë dështimin e vet për të respektuar ligjin si arsye për të eliminuar një operator ekonomik për skadim të validitetit apo afatit të vlerësimit apo rivlerësimit.

Pavarësisht kësaj, AK – MKRS ka vepruar në kundërshtim të hapur me nenin 26, paragrafi 4 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që, nëse ka nevojë për kohë shtesë, të kërkojë vazhdimin e validitetit para skadimit të tij. AK – MKRS, përmes pasivitetit të qëllimshëm, ka lejuar skadimin e afateve pa dërguar asnjë kërkesë zyrtare tek ne si Operator Ekonomik dhe tani tentohet të përdoret dështimi procedural si bazë për eliminimin tonë.

Ky veprim përbën keqpërdorim të procedurës për të prodhuar një rezultat të jashtëligjshëm – eliminimin e fituesit. Ne, si OE, në mënyrë vullnetare kemi vazhduar validitetin e ofertës pa e kërkuar AK, njëkohësisht duke korrigjuar veprimet kundërligjore të saj. Veprimet e AK-së nuk do të amnistohen, pavarësisht kostos, pasi ekzistojnë prova konkrete, reale dhe në sasi të konsiderueshme ndaj veprimeve të tilla.

Neni 97 i Rregullores nr. 001/2022 për zvarritje të procedurës dhe anulim të qëllimshëm e sanksionon dhe e penalizon secilin zyrtar përgjegjës dhe veprimet e tilla konsiderohen shkelje e rëndë e ligjit.

Veprimet e AK – MKRS janë në përputhje të plotë me figurën e shkeljes që parashihet në nenin 97, pasi ka pritur që validiteti të skadojë dhe nuk ka kërkuar vazhdimin e tij, duke shkelur në tërësi nenin 44.2 të LPP-së dhe nenin 30.4 të Rregullores për Prokurim Publik, dhe tani tentohet të përdoret ky fakt për të eliminuar kompaninë tonë “Standard Home Furniture” LLC. Ky është një keqpërdorim i hapur i autoritetit zyrtar dhe për këtë duhet të vihen para përgjegjësisë.

Pretendimi ankimor 4:

Po ashtu, çështja e gjuhësisë dhe arsyetimit të eliminimit të kompanisë sonë, sipas praktikës së OSHP-së dhe vendimeve të viteve 2023–2025, tregon se eliminimi i një Operatori Ekonomik për shkak të dokumenteve në gjuhë të huaj, si frëngjishtja apo gjuhë tjetër, pa kërkuar paraprakisht përkthimin e tyre, përbën shkelje të nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

OSHP ka vendosur në raste të shumta se AK përkatës nuk mund të pretendojë se nuk mund të vlerësojë dokumentin pa e njoftuar dhe pa kërkuar sqarim nga OE. AK – MKRS, duke mos na ftuar për sqarim, ka vepruar në kundërshtim me parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë, krejt kjo me qëllim të eliminimit të qëllimshëm të kompanisë sonë.

Për më tepër, KRPP ka të publikuar opinionin e saj në ueb-faqen zyrtare, ku shprehimisht përcaktohet se nëse AK përkatës ka pasur nevojë të vërtetojë një detaj specifik teknik që gjendet në broshura apo dokumente tjera, ajo duhej të kërkonte përkthimin e asaj pjese specifike, e jo të eliminonte tërë ofertën që është më e lira dhe e përgjegjshme.

OSHP në praktikë këtë veprim e sanksionon dhe e konsideron si shkelje të rëndë, e cila dëmton buxhetin e shtetit. AK – MKRS ligjërisht është e detyruar të kërkojë përkthimin e certifikatave, sidomos pasi në vlerësimin e parë na kishte shpallur fitues, gjë që vërteton se gjuha nuk ishte pengesë për vlerësim asokohe, por që qëllimi ishte i qëllimshëm dhe i dëmshëm. Për këtë, kompania jonë nuk do të kursehet për t'i vënë para përgjegjësisë zyrtarët përkatës.

Prandaj, AK – MKRS, para ndërmarrjes së këtyre veprimeve, do duhej të merrte në konsideratë praktikën e OSHP-së, ku në raste identike është vendosur se:
AK-ja nuk mund të eliminojë një OE për dokumentacion në gjuhë të huaj pa i ofruar mundësinë që OE ta dorëzojë përkthimin zyrtar sipas nenit 72 të LPP-së, dhe çdo vendim ndryshe nga ky duhet të konsiderohet si tendencë e qëllimshme për eliminim të operatorit më të lirë përmes barrierave artificiale.

Pretendimi ankimor 5:

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK – MKRS dhe pas rivlerësimit dhe të gjeturave nga kërkesa për rishqyrtim paraprak, rezulton se Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë nuk kanë pasur validitet të ofertës dhe sigurim të tenderit në fuqi gjatë fazave kyçe të rivlerësimit.

Sipas nenit 44 të LPP-së dhe nenit 26 të Rregullores, një tender që nuk është i mbuluar me sigurim tenderi dhe nuk ka validitet kohor është juridikisht i pavlefshëm.

AK – MKRS ka konsumuar shkelje të rëndë duke i trajtuar këta OE si “palë të interesuara”, pasi ata nuk mund të shpallen fitues në asnjë rrethanë. Kjo çështje nuk është trajtuar fare përmes vendimit të datës 22.01.2026 ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim.

Neni 108/A i LPP-së përcakton se kërkesa për rishqyrtim mund të parashtrohet vetëm nga një palë e interesuar, dhe një OE që i ka skaduar sigurimi i tenderit e humb interesin legjitim, sepse oferta e tij është administrativisht e papërgjegjshme. Duke u bazuar në ankesat e tyre për të eliminuar kompaninë tonë, AK – MKRS ka lejuar që subjekte jashtë procesit ligjor të diktojnë fatin e kësaj procedure të prokurimit kaq të rëndësishme për sistemin edukativ dhe fizik në gjithsej 38 komuna në vend.

Të gjitha këto veprime janë paradoksale dhe diskriminuese. AK – MKRS tenton të eliminojë kompaninë “Standard Home Furniture” LLC, e cila ishte fituese në vlerësimin paraprak, me pretekstin e validitetit të certifikatave dhe gjuhës së tyre, ndërkohë që në të njëjtën procedurë mban si aktive dhe legjitimon ankesat e OE-ve të tjerë që kanë dështime më të rënda administrative, teknike dhe financiare.

Ky standard i trefishtë vërteton pretendimin tonë se AK – MKRS nuk po vepron ligjërisht për të mbrojtur ligjin, por po përdor instrumentet ligjore në mënyrë selektive për të eliminuar ofertën tonë më të lirë dhe për t'i krijuar mundësi përsëri për ofertim kompanisë që po tentohet tash e 3 vite të kontraktohet.

Udhëzuesi nr. 001/2023 për Prokurim Publik, neni 10, është i qartë dhe trajton çështjet e plotësimit të informacionit që mungon apo është i paqartë.

Për shkak të këtyre shkeljeve të përsëritura dhe ndryshimit të vendimit nga “I suksesshëm” në “I eliminuar” pas më shumë se 6 muajsh, për arsye që janë pasojë e vonësive të vetë AK-së, ekziston dyshimi i bazuar për konsumim të veprave penale. Nëse ky vendim nuk korrigjohet dhe nuk ndërmerren veprime ligjore, ne si kompani nuk do të kursejmë asnjë zyrtar përkatës dhe përmes përfaqësuesve ligjorë do ta dorëzojmë lëndën në Departamentin për Krime Ekonomike dhe në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për të hetuar përfshirjen e mundshme në krim të organizuar dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e zyrtarëve të MKRS-së që kanë manipuluar me afatet dhe kriteret e këtij tenderi.

Sipas nenit 52.3 dhe nenit 56.3 të LPP-së, qartë përcaktohet se tenderuesi nuk do të diskualifikohet në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK – MKRS po tenton të eliminojë kompaninë tonë për kërkesa që nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit apo njoftimit për kontratë. Anulimi i procedurës së prokurimit me arsyetim të tillë dhe në këtë fazë përbën shkelje të rëndë të nenit 97 të Rregullores nr. 001/2022.

Prandaj, kompania jonë kërkon që OSHP dhe zyrtarët përgjegjës të autorizojnë ekspert të paanshëm, me integritet moral dhe profesional, në mënyrë që të trajtojnë të gjitha pretendimet tona ankimore dhe të evidentojë shkeljet e kryera nga AK – MKRS.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Fatmir Godeni” B.I.janë parashtruar si në vijim:

Të pakënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK, të datës 15.01.2026, ku na refuzohet kërkesa për rishqyrtim në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Furnizim [kornizë] me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës [Ri-tenderim i dytë], me nr. të prokurimit: 207-25-936-1-1-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: 207-25-008-1-1-1, ne në afatin ligjor, konform nenit 109 të LPP-së, e ushtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së:

Për shkak se AK – MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK:

1. Në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për Kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT).
2. Në mënyrë të kundërligjshme ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, pasi që ne kemi ofertuar me tender të përgjegjshëm, duke i plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për Kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT).

Sqarojmë në mënyrë të detajuar:

Autoriteti Kontraktues – AK MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK në mënyrë të kundërligjshme ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, pasi që ne kemi ofertuar me tender të përgjegjshëm dhe AK është dashur ta vazhdojë këtë procedurë duke e përfunduar në mënyrë të suksesshme dhe duke e publikuar njoftimin për dhënie të kontratës, e jo njoftimin për anulim.

AK si arsye të anulimit e ka cekur si në vijim:

Pra, nuk e ka cekur asnjë arsye të anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, e as në bazë të cilit nen të cilit ligj duhet kjo procedurë të anulohet, por çka është më së keqi, e ka anuluar pas aprovimit të buxhetit, si më sipër në arsyetim, dhe e ka cekur se:

Pra, sipas AK paska dashur të ofertohej me oferta të njëjta apo çfarë qëllimi ka qenë kjo, neve e kemi të paqartë. AK, në momentin që e shpall një procedurë të prokurimit, duhet ta dijë mirë se nuk ka kthim prapa. Zyrtarët e prokurimit të secilit AK kryejnë rregullisht trajnime për LPP dhe duhet ta kenë të qartë se pas hapjes së ofertave, kur duhet të anulohet një procedurë e prokurimit sipas LPP-së.

Si arsye e anulimit dhe e eliminimit, në letrën standarde AK ka cekur se:

Pra, AK në NJK dhe DT ka vendosur kërkesën si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2
Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1.1 – Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës dhe, për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre (3) viteve të shkuara ka zbatuar kontrata (gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme) për furnizime me rekuizita dhe pajisje sportive (ngjashëm me ato të kërkuara në kornizë të kësaj lënde), në shumën e përgjithshme prej 1,000,000.00 € (një milion euro).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa 1.1.1 – Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin si në vijim: “Kontratat dhe Raportet e pranimi të mallrave”, të lëshuara nga autoritetet kontraktuese publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave përkatëse – një (1) kopje e origjinalit; OSE “Certifikatat/Referencat e përfundimit të kontratës”, të lëshuara nga autoritetet kontraktuese publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave përkatëse – një (1) kopje e origjinalit.

Kërkesa 1.1.2 – Për të gjitha “Kontratat dhe Raportet e pranimi të mallrave” dhe/ose “Certifikatat/Referencat e përfundimit të kontratës” të deklaruara, Operatori ekonomik duhet të plotësojë në tërësi Tabelën nr. 1 – një (1) kopje e origjinalit.

Pra, neve AK na ka njoftuar se, sipas tyre, i kemi 647,374.70 € kontrata të vlefshme të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit. Tani lind pyetja pse nuk është e vlefshme kontrata me numër 72 dhe 73, kur gati e tërë kontrata ka qenë furnizim me pajisje sportive të ngjashme, të cilat janë edhe në paramasat e këtij aktiviteti të prokurimit, ku vetëm edhe me këto dy kontrata po e tejkalojmë kërkesën e AK-së.

Pastaj kontrata me numër 80, 81, 82, 83, 84, ku AK i ka shikuar vetëm numrat e prokurimit, por kontrata me numër 80, edhe sipas numrit të prokurimit, është furnizim, pra njëjtë sikurse ky aktivitet i prokurimit. Kontratat e tjera disa e kanë shërbime e disa punë, pasi që janë të përziera. Për kontratat e përziera që përfshijnë furnizime, shërbime dhe punë, numri i prokurimit caktohet sipas komponentës me vlerën më të lartë financiare, e cila konsiderohet objekti kryesor i kontratës; njëjtë edhe në këto raste AK-të e kanë përcaktuar.

Lloji i prokurimit (dhe rrjedhimisht numri i prokurimit) përcaktohet nga furnizimi, shërbimi ose puna që përbën pjesën dominuese financiarisht të kontratës.

Pra, shihet qartë se AK na ka diskriminuar haptas në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që jo vetëm që e kemi plotësuar kërkesën e AK-së, por e kemi tejkaluar dyfish atë kërkesë.

Neve ua kemi bashkangjitur të gjitha kontratat dhe raportet e pranimeve teknike. Gjithashtu shumë qartë shënohet nëpër paramasa, pasi që jemi kompania e vetme në Republikën e Kosovës që merremi me këtë lloj aktiviteti, ku i kemi lokalet dhe jemi të vetmit që bëjmë furnizimin me pajisje sportive jo vetëm për institucione shtetërore, por edhe për persona të tjerë juridikë e privatë në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe, me një fjalë, jemi të vetmit të specializuar për këto lloj aktivitetesh, ku me ndershmëri dhe profesionalizëm e kemi ngritur kompaninë tonë në nivelin në të cilin jemi si kompania më profesionale dhe më e besueshme në vend për furnizim me të gjitha llojet e pajisjeve sportive.

Neve me kënaqësi ju ftojme të vini për vizitë në lokalet tona dhe të bindeni edhe më shumë me profesionalizmin tonë, edhe pse ju kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme.

Në bazë të kontratave që i kemi prezantuar, e kemi dëshmuar se ne jemi të profesionalizuar për të gjitha llojet e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve që kanë të bëjnë me pajisje sportive.

Gjithashtu, edhe gjatë vlerësimit të stërzgatur, AK i ka shkelur të gjitha procedurat e prokurimit me këto veprime të kundërligjshme. Pra, AK me datën 01.04.2025 i hap ofertat, kurse gati pas një viti e publikon njoftimin për anulim, ku kundërligjshëm i merr këto veprime, pasi që dihet qartë se sipas rregullores, konkretisht neni 40.3, thuhet:

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Ndërsa AK-së i është dashur kohë gati një vit për ta vlerësuar këtë aktivitet të prokurimit dhe në fund duke e dështuar, pra duke mos e finalizuar me njoftim për dhënie, por me anulim të kundërligjshëm.

Neve kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me pretendimet e njëjta si më sipër dhe AK na kthen përgjigje të njëjtë se:

Pra, AK as që e ka marrë mundin t'i shikojë pozicionet e këtyre kontratave. AK duhet ta dijë se nuk ka kërkuar kontrata të njëjta, por të ngjashme. Të ngjashme janë të gjitha kontratat, pasi që të gjitha kontratat tona janë për pajisje sportive, sepse ne merremi vetëm me furnizim të pajisjeve

sportive e jo me lëmi tjera. Limitet e shprehjes “të ngjashme” janë shumë të pacaktuara. AK nuk ka kërkuar kontrata të njëjta.

Gjithashtu AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, ku në pikën 1 thuhet se: Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Ndërsa në pikën 2 thuhet:

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, ku thuhet:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Tenderi ynë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK për këtë aktivitet të prokurimit ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar as nenin 60 të LPP-së. Kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Pra, ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Me anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, AK ka bërë shkelje të nenit 62 të LPP-së, pasi që asnjë pikë e këtij neni nuk plotësohet në këtë rast që po e përshkruajmë. (Teksti i nenit vazhdon si i cituar më sipër.)

Gjithashtu neni 43.5 i Rregullores përcakton pikat në të cilat, në këtë rast konkret, asnjë nga këto kushte nuk qëndron. Nëse i lexojmë me kujdes arsyet e anulimit të një aktiviteti të prokurimit sipas rregullores, asnjëra prej tyre nuk qëndron, për arsye se:

- a) Asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar – janë paraqitur më shumë se një tender brenda afatit të specifikuar.
- b) Asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm – tenderi ynë është i përgjegjshëm.
- c) Numri i OE-ve të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se tre (3) – kjo pikë nuk është për këtë procedurë, pasi që procedura është kontratë publike kornizë me një operator ekonomik.
- d) Nuk ka kërkesa për të marrë pjesë në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata – kjo pikë nuk është për këtë procedurë, pasi që ky aktivitet ka qenë me procedurë të hapur.
- e) Numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/konkurruese me negociata është më pak se tre (3) – kjo pikë nuk është për këtë procedurë.
- f) Nuk ka projekte të paraqitura brenda afatit – kjo pikë nuk është për këtë procedurë.
- g) Asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshme – kjo pikë nuk është për këtë procedurë.
- h) Nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit – nuk ka asnjë urdhër nga OSHP për

anulim.

i) Një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet – kurrfarë shkelje e asnjë neni të asnjë ligji nuk ka ndodhur; nuk është cekur në B58 asnjë shkelje, asnjë nen i asnjë ligji; pra edhe kjo pikë nuk vlen.

j) Nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe ky gabim me verifikim të KRPP-së është i pariparueshëm – nuk qëndron.

k) Nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP – as kjo nuk qëndron.

Anulimi i procedurës është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim Publik, duke keqpërdorur diskrecionin dhe duke tejkaluar kompetencat që i njeh ligji Autoritetit Kontraktues.

Ne si operator ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit jemi palë me interes juridik material konform nenit 4, paragrafi 1.26 të LPP-së, pasi që në çdo mënyrë kemi dëshmuar se këto shkelje të AK-së na shkaktojnë dëme të drejtpërdrejta, pasi që në këto rrethana dhe fakte është dashur që ne të shpallemi fitues i këtij tenderi.

Anulimi, në këtë rast, është përdorur si mjet për të shmangur përfundimin e procesit dhe për të anashkaluar ofertën tonë konkurruese. Sa i përket operatorëve që kanë ofertuar me çmime më të lira se ne, ju sqarojmë se botërisht dihet që asnjëra prej tyre nuk e kanë profesion llojin e këtij aktiviteti të prokurimit, por e kanë profesion shtypshkronjat. Pra, nuk kemi çka të shtojmë më tepër, por ky aktivitet nuk është shtypja e librave, por furnizim me pajisje sportive, ku jemi të vetmit të specializuar në këtë lëmi.

Besojmë se i kemi elaboruar më shumë se sa duhet shkeljet e AK-së në këtë aktivitet të prokurimit, andaj kërkojmë nga OSHP-ja ta detyrojë AK-në që t'i respektojë në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi dhe t'i respektojë kërkesat e veta që vet i ka vendosur në NJK dhe DT lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 04.02.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0061/2026 ndërsa me datën 04.02.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0067/2026, ndërsa me datë 16.02.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0061/26&0067/2026.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “Standard Home Furniture” L.L.C. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0061 kanë vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës është 2,000,000.00€. Ndërsa, kriter i dhënies së kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 25, 27, 40, 44, 56, 59, 69, 72, 108/A dhe 130 të LPP-së, si dhe nenin 30, 38, 40 dhe 97 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës 15.12.2025, OE ankues “Standard Home Furniture L.L.C”- Prishtinë ka qenë i rekomanduar për kontratë. Pastaj AK me datë 15.01.2026 nxjerrë Njoftimin mbi vendimin e AK-së, duke e anuluar aktivitetin e prokurimit. Në këtë njoftim përmes të cilit është anuluar procedura, AK nuk ka dhënë arsyetim konkret por vetëm e ka cekur se kanë ofertuar pesë OE, ndërsa asnjë operator ekonomik nuk shpërblehet me kontratë, ku sipas këtij njoftimi të gjithë OE-të kanë statusin e OE të eliminuar.

Bazuar në Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar, OE ankues “Standard Home Furniture L.L.C”- Prishtinë, është eliminuar me arsyetimin si vijim:

“Mos përmbushje e kërkesave 1.1 – 10.1 të FDT-së Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm të prodhuesit për dëshmimin e pajtueshmërisë teknike, veçantë për secilin artikull sipas Kapitujve I deri në X (respektivisht kriteret 1.1. deri në 10.1), siç kërkohet shprehimisht në FDT. Pasi që i njëjti ka paraqitur

Dorëzim i certifikatave të skaduara - OE ka paraqitur mbi 30 certifikata me afat të skaduar, të cilave u ka përfunduar vlefshmëria gjatë vitit 2023 dhe në dhjetor 2024, pra para njoftimit për kontratë dhe para hapjes së ofertave. Si të tilla, këto dokumente nuk janë valide dhe nuk mund të merren në konsideratë për vlerësim teknik. OE ka paraqitur Certifikatat numër: 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 22, 25, 26, 27, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 38, 39, 40, 48, 51, 53, 54, 55, 79, 86, 117, 119 të skaduara, të gjitha këto certifikata janë pa afat sikur Certifikata e bashkangjitur me poshtë (vetëm forme shembulli).”

“Mospërputhje dhe kontradiktë në prodhues Numëri i prokurimit: 207-25-936-1-1-1 OE ka paraqitur certifikata nga Shandong Taishan Sports Equipment Co., Ltd (Kinë), nuk ka dorëzuar asnjë katalog apo fletë teknike për artikujt përkatës (nga ky prodhues), përmes së cilës do të mundësohej verifikimi i pajtueshmërisë teknike dhe ekzistenca e CE-markimit për produktet e ofruara. OE në një pjesë të dokumentacionit ka bashkëngjitur materiale që i referohen prodhuesit Shandong Taishan Sports Equipment Co., Ltd (Kinë), ndërsa në pjesë të tjera ka paraqitur certifikata që i referohen prodhuesit francez CASALSPORT / ACTIVEUM (Francë), i cili nuk ka lidhje të dëshmuar as me Shandong Taishan dhe as me STANDARD HOME FURNITURE L.L.C. Kjo krijon paqartësi dhe pamundëson verifikimin e origjinës së produkteve.

OE ka paraqitur katalogë dhe certifikata në gjuhën frënge, pa përkthim zyrtar, gjë që është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, sipas të cilave dokumentacioni duhet të dorëzohet në gjuhët e pranuar nga AK (pjesa poshtë është pjesë e bashkangjitur nga një faqe në katalog që dëshmon gjuhën frënge dhe jo atë që lejohet përmes LPP-se Anglisht apo Serbisht). ”

Disques à lancer scolaires économiques. Fabrication en caoutchouc de différentes couleurs pour mieux différencier les poids.

Dimensions disponibles:

- Poids: 600 g/diamètre 15 cm

- Poids: 800 g / diamètre 16 cm

-Poids: 1 kg / diamètre 18 cm

- Poids: 1.25 kg /diamètre 19 cm

- Poids: 1.5 kg/diamètre 20 cm

- Poids: 1.75 kg /diamètre 21 cm

- Poids: 2 kg / diamètre 22 cm.

“Andaj bazuar në: UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimit teknik”-AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në rastet kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar) Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara Në të dy rastet specifikohet që: Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm”

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se me datë 19.01.2026 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, ku në të njëjtën kërkesë kanë qenë të përfshira katër pretendime ankimore me fakte dhe prova dhe bazë ligjore, pavarësisht kësaj AK –MKRS, me datën 22.01.20216 nxjerrë vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim pa e trajtuar as një pretendim ankimor potencon ankuesi, si dhe shton se me këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 108/A par. 9 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Bazuar në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim të AK-së, të datës 22.01.2026, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK nuk ka kthyer përgjigje për secilin pretendim ankimor, ashtu siç e obligon neni 108/A i LPP-së, por i ka sqaruar OE ankues arsyet e eliminimit, ku në këtë përgjigje ndër të tjera thuhet “Tendenca për ti japur kahje tjetër pretendimeve ankimore krahas asaj se për çfarë jeni eliminuar nuk janë arsyetim për të aprovuar kërkesën për rishqyrtim...”. Andaj, **ekspertja shqyrtuese** konsideron se AK në përgjigje të

kërkesës për ri shqyrtim i jep arsytet e mjaftueshme për eliminimin e OE ankues, kurse sa i përket çështjeve tjera procedurale, ekspertja do të jep përgjigjet më poshtë.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues potencon se AK-MKRS, komisioni i ri vlerësimit të ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit me arsytet e përshkruara në letrën standarde ndaj ofertës sonë përveç se kanë konsumuar shkelje esenciale të dispozitave ligjore për prokurim publik, kanë konsumuar edhe vepër penale e cila është e sanksionuar me nenin 414 dhe 415 të KPRK-së, për këto veprime detyrimisht do të kërkohet përgjegjësi në Prokurorinë Speciale të Kosovës. Tutje, OE ankues shton se arsyetimi i eliminimit të ofertës se tyre se dokumentet - certifikata e dorëzuara nuk vërtetojnë specifikacionet teknike të kërkuara për rekuizita sportive, gjegjësisht mos përmbushja e kërkesave 1.1.-10.1 të FDT-së, janë krejtësisht kundërligjore dhe AK-MKRS askund në kërkesa kualifikuese nuk ka kërkuar që këto certifikata duhet të jenë valide apo diç të tillë. Tek kërkesat e kapacitetit profesional nga pika 1.1 deri tek pika 1.10, AK ka kërkuar që të dorëzohet dokumentacioni për produktin, përkatësisht për secilin kapitull veç e veç. Më tej, OE ankues potencon se AK-MKRS do duhet të ishte e vetëdijshme se produktet sportive të kërkuara në pikën 1.1-1.10 janë mallra që posedojnë përditësim të vazhdueshëm specifike dhe teknike. AK-MKRS sipas nenit 59.4 dhe 72 të LPP-së, ka pasur detyrim ligjor që të kërkoj sqarime plotësues shtesë për të na mundësuar dorëzimin e certifikatave të përditësuara dhe me validitet e jo të përdor këtë formalitet si mjet për eliminim arbitrar të ofertës sonë, ani pse në vlerësimin paraprak kemi qenë të rekomanduar për kontratë. OE ankues shton se OSHP, gjegjësisht paneli shqyrtues bazuar në ligjin në fuqi, këtë lëndë do duhet ta depononin në MPB zyrtarisht të kërkonin inicim të hetimit dhe krimit të organizuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese fillimisht i sqaron operatorit ekonomik ankues se OSHP është organ i pavarur për shqyrtim administrative dhe nuk merret me hetime penale. Andaj, nëse OE ankues konsideron se ka elemente të veprës penale mund ti drejtohet organeve kompetente për hetim. Për tu kthyer të pika ankimore, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, tek “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Kërkesa 1.1 deri 10.1, ka kërkuar:

Kërkesa 1.1. -Operatori ekonomik, është i obliguar që gjatë procedurës së prokurimit, bashkërisht me dokumentacionin e kësaj lende, të dorëzojë edhe dokumentacion të prodhuesit në vijim [për dëshmuar pajtueshmërinë teknike]- veçantë për secilin artikull, pjesë e ‘Kapitullit I’.

Dëshmia e kërkuar dokumentare-

Kërkesa 1.1.1. [Zbatohet për të gjithë artikujt] - Certifikata e prodhuesit e cila konfirmon se secili artikull, pjesë e ‘Kapitullit I’, i ofruar është prodhuar në pajtim me Standardin Evropian [‘European Standard- EN’] përkatës, të miratuar nga Komiteti Evropian për Standardizim [‘European Committee for standardization- CEN’] dhe në pajtim me Direktivat e Unionit Evropian për shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit -Një [1] kopje e origjinalit. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.2. [Zbatohet për të gjithë artikujt] - Ekstrakt nga katalogu zyrtar i prodhuesit, për secilin artikull, pjesë e ‘Kapitullit I’, i cili përmban edhe fotografinë - Një [1] kopje e origjinalit. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.3. [Zbatohet për të gjithë artikujt] - Deklarata e garancisë së prodhuesit për secilin artikull, pjesë e ‘Kapitullit I’- mbulesa dhe kohëzgjatja [së paku dymbëdhjetë [12] muaj], përkatëse - Një [1] kopje e

originalit.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në kërkesën e AK-së, përkatësisht pika 1.1 deri 10.1 dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare, sqaron se OE ankues në lidhje me këtë kërkesë vlerëson se AK nuk ka kërkuar që certifikatat e kërkuara sipas kërkesës së lartcekur duhet të kenë vlefshmëri (validitet). Mirëpo, **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se përderisa një dokument ka një datë të lëshimit dhe ka një datë të skadimit, është më së e kuptueshme se pas datës së skadimit nuk ka vlefshmëri. Në lidhje me këtë, bazuar në ofertën e OE ankues, konkretisht në dokumentin me titull **“1.9.1.Deklarata garantuese dhe certifikata._compressed.pdf”**, rezultojnë mbi 30 (tridhjetë) certifikata me afat të skaduar, të cilave ju ka përfunduar vlefshmëria gjatë vitit 2023-2024. Andaj, të gjitha këto certifikata rezultojnë me afat të skaduar para datës së njoftimit për kontratë (18.02.2025) dhe para hapjes së ofertave (15.04.2025) . Në rastin konkret, përderisa lëshuesi i certifikatës e ka cekur datën e skadimit (expiry date), atëherë nënkuptohet se pas asaj date, certifikata e tillë nuk vlen. Pra, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues potencon se AK-MKRS jo të vetëm në këtë rast te ri vlerësimi të ofertave ka tejkaluar çdo afat ligjor të mundshëm për vlerësim dhe rivlerësim të ofertave. Sipas nenit 44 të LPP-së, periudha e vlefshmërisë së ofertave është e limituar, ndërsa nenin 59 i LPP-së, kërkon një proces vlerësimi të shpejtë dhe jo me shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave bazuar edhe në nenin 40 të rregullores nr. 001/2022 zvarritja prej me shumë se 6 muaj në këtë aktivitet prokurimi nuk është pasojë e kompleksitetin por mjet i përdorur qëllimisht për të shkaktuar skadimin e validitetit të ofertave dhe sigurimeve të tenderit të kompanisë sonë si fitues dhe e rekomanduar për kontratë në vesimin paraprak. Tutje, OE ankues potencon se “AK është e obliguara që vlerësimin ta përfundojë brenda afatit maksimal prej 30 ditëve ose 45 në raste jashtëzakonshme komplekse”, nenin 40.3 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, çdo vonësë pas këtij afati pa asnjë arsytim objektiv dhe pa njoftuar KRPP-në përbenë shkelje administrative dhe cenon parimin e efikasitetit. Pastaj, OE ankues shton se neni 97 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, për zvarritje të procedurës dhe anulim të qëllimshëm e sanksionon dhe penalizon secilin zyrtar përgjegjës dhe veprimet e tilla konsiderohen shkelje e rendë e ligjit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të publikuar në platformën e e-prokurimit dhe shkresave të lëndës, sqaron se më datë 18.02.2025, ora 14:39, AK ka publikuar dokumentin “B04 – Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Fondeve”, ku vlera e parashikuar e kontratës është 2,000,000.00 euro. Në të njëjtën datë është publikuar edhe Njoftimi për Kontratë. Më pas, më datë 28.03.2025 dhe 02.04.2025, AK ka publikuar dokumentin B54 – Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara. Në bazë të njoftimit për kontratë, pesë (5) operatorë ekonomikë kanë dorëzuar oferta, ndërsa hapja e ofertave është bërë më 15.04.2025. Me datë 17.06.2025, AK ka publikuar B58 – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ndërsa më 25.06.2025 është publikuar vendimi për kthimin e lëndës në rivlerësim. Pas një periudhe pothuajse 5 muaj, më saktë me datë 15.12.2025, AK ka publikuar B58 – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke e rekomanduar fitues OE ankues “Standard Home Furniture”. Pastaj AK me datë 15.01.2026 nxjerrë Njoftimin mbi vendimin e AK-së, duke e anuluar aktivitetin e prokurimit. Duke pasur parasysh historikun e këtij aktiviteti të

prokurimit, **ekspertja shqyrtuese** bazuar në këto veprime të AK-së vlerëson se AK ka ndërmarrë veprime procedurale për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, numri i madh i veprimeve të ndërmjetme, kërkesave për sqarime shitesë, njoftimeve mbi vendimet dhe kërkesave për rishqyrtim kanë zgjatur /konsumuar afate të konsiderueshme kohore. Megjithatë, periudha e pushimit apo pritjes prej muajit qershor 2025 deri në dhjetor 2025, pa ndërmarr asnjë veprim për vlerësim të ofertave, për mendimin e **ekspertes shqyrtuese** është në kundërshtim me nenin 40.3 të Rregullores Nr.002/2024. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues potencon se arsyeja e eliminimit të kompanisë së tyre nga AK për çështjen e gjuhësisë sipas praktikës së OSHP-së dhe vendimeve të viteve 2023-2025, eliminimi i një Operatori ekonomik për shkak të dokumenteve në gjuhë të huaj si frëngjishtja apo gjuhë tjetër pa kërkuar përkthimet e tyre përben shkelje të nenit 59 dhe 72 të LPP-së. Tutje, OE ankues potencon se OSHP ka vendosur në raste të shumta se AK përkatëse nuk mund të pretendojë se nuk mund të vlerësojë dokumentin pa e njoftuar dhe pa kërkuar sqarime nga OE. Krpp ka publikuar opinione e saj ne ueb faqe, ku shprehimisht përcaktohet se nëse AK përkatëse ka pasur nevojë të vërtetoj një detaj specifik teknik që gjendet ne broshurë apo dokumente tjera ajo duhet të kërkonte përkthimin e asaj pjese specifike e jo të eliminohet oferta që është më e lira dhe e përgjegjshme.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Ekspertja shqyrtuese se bazuar në Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar OE ankues nder të tjerat është eliminuar edhe për arsye se *“ka paraqitur katalogë dhe certifikata në gjuhën frënge, pa përkthim zyrtar, gjë që është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, sipas të cilave dokumentacioni duhet të dorëzohet në gjuhët e pranuar nga AK (pjesa poshtë është pjesë e bashkangjitur nga një faqe ne katalog qe dëshmon gjuhen frënge dhe jo atë qe lejohet përmes LPP-se Anglisht apo Serbisht).”*

Pas shqyrtimit të ofertës së dorëzuar të OE, ankues përkatësisht të dokumentit me titull **“1.10.1.Certifikata dhe lista garantuese..pdf”**, rezulton se katalogu dhe certifikata janë në gjuhën frënge dhe për to nuk është bashkangjitur përkthimi zyrtar në gjuhët zyrtare të përcaktuara në nenin 13 paragrafi 4 të LPP-së, i cili përcakton: *“4.Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”*.

Sipas nenit 13.4 të LPP-së tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Si rrjedhojë, shihet se për gjuhë tjera që dorëzohen me tender nuk ka ndonjë përjashtim.

Lidhur më këtë dispozitë ligjore që rregullon çështjen e gjuhës me rastin e dorëzimit të tenderit, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se KRPP si organ rregullativ dhe i vetmi i cili interpreton (neni 87, par. 2.7 i LPP-së) ka publikuar dy opinione (opinionit me nr. 7 dhe 13) të cilët sqarojnë si në vijim:

7. 22.11.2022 A duhet të refuzohet tenderi apo të kërkohe sqarime sipas 72, i cili ka sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me LPP?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron OPINIONIN si në vijim:

Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton:

“13.4 Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”

Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përsëritet në format standarde të dokumenteve të tenderimit të miratuara nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me LPP.

Sipas dispozitave të lartpërmendura tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur.

Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 13 të LPP-së dhe format standarde (dokumentet e tenderimit), KRPP ofron këtë OPINION:

Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësojë tenderin.

Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:

1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;

2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Sipas përvojës, në fakt, specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë

ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze.

Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike.

Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit.

3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

4) parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore të tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar. Në të kundërt, në rastin e përmendur, OE ka paraqitur në një gjuhë tjetër specifikimet teknike të cilat përfaqësojnë një pjesë thelbësore dhe të nevojshme për pranimin e tenderuesit.

Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet.

Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohej nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument.

13. 22.06.2023 Si duhet të veprojë AK, në rast se një tenderues paraqet ndonjë dokument të tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron këtë:

OPINION

Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton:

“Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”.

Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përshkruhet në dokumentet standarde të tenderit.

Sipas dispozitës së lartpërmendur, tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur.

Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojnë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së.

Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësojë tenderin.

Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:

1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;

2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze.

Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike.

Pra, sjellja e dokumenteve në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë e OE.

3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit.

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

4) Parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore të tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të

detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar.

Specifikimet teknike pjesë thelbësore e tenderit, prandaj, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet.

Ndërsa për cilindro dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument.

Andaj, duke u bazuar në dëshmitë në platformën e prokurimit dhe shkresat e lëndës, OE ankues me ofertë ka dorëzuar katalogun dhe certifikata në gjuhën frënge, pra në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar në nenin 13.4 të LPP-së. Për më tepër, duke u bazuar edhe në dy opinionet si më lartë të KRPP-së, rezulton se OE që sjellin dokumente në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me nenin 13.4 të LPP-së e që kanë të bëjnë me specifikacionin teknike, përjashtimi është i pa kontestueshëm.

Specifikimi teknik si (katalogu dhe certifikata) është kërkesë themelore, të së cilës duhet të përmbahen në përpikëri operatorët ekonomik pjesëmarrës me rastin e përgatitjes së tenderit, për faktin se paraqet detyrim kryesor për fushëveprimin e aktivitetit të prokurimit, për shkak se specifikimet teknike si katalogu i përkasin nenit 28 të LPP-së dhe nuk mund të sqarohen sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 5: OE ankues potencon se sipas njoftimit mbi vendimin AK-MKRS dhe pas rivlerësimit dhe të gjeturave nga kërkesa për rishqyrtim paraprak, rezulton se operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë nuk kanë pasur validitet të ofertës dhe sigurim të tenderit në fuqi gjatë fazave kyçe të rivlerësimit dhe se sipas nenit 44 të LPP-së, dhe nenit 26 të Rregullores një tender që nuk është i mbuluar me sigurim tenderi dhe nuk ka validitet kohor është i vdekur në aspektin juridik. Tutje, OE ankues potencon se AK ka konsumuar shkelje të renda duke i trajtuar këta OE si “palë të interesuara” pasi ata nuk mund të shpallen fitues në asnjë rrethanë dhe kjo çështje nuk është trajtuar fare përmes vendimit të datës 22.01.2026 ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, me këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 108/A të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5: Ekspertja shqyrtuese bazuar në platformën e - prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit sqaron se AK më datë 20.08.2025, ka bërë kërkesë për zgjatjen e validitetit dhe sigurimit të tenderit dhe sipas kësaj kërkesë të AK-së, afati i fundit për konfirmimin e zgjatjes së vlefshmërisë së ofertave ka qenë data: 25.08.2025.

Po ashtu, AK më datë 17.11.2025, përsëri ka bërë kërkesë për zgjatjen e validitetit dhe sigurimit të tenderit dhe sipas kësaj kërkesë të AK-së, afati i fundit për konfirmimin e zgjatjes së vlefshmërisë së ofertave ka qenë data: 24.11.2025.

Bazuar në Njoftimin mbi vendimin e AK-së të datë 15.01.2026 si dhe letrat standarde për tenderuesit e eliminuar rezultojnë se dy nga pesë (5) operatorët ekonomik pjesëmarrës për këtë aktivitet të prokurimit nuk kanë vazhduar validitetin dhe sigurimin e ofertës, andaj dhe ndër arsytet e tjera janë eliminuar dhe për mos vazhdimin e validitetit dhe sigurimin e ofertës.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit kanë dorëzuar ankesë pranë OSHP-së, dy (2) operatorë ekonomik, ankesa me numër të protokollit NR. 2026/061 dhe 2026/067. Sa i përket ankesës Nr. 2026/061, ekspertja shqyrtuese konsideron se ankesa është e pabazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ta anuloj njoftimin mbi anulim të datës 15.01.2026, dhe ta kthej lëndën në rivlerësim, si rezultat i ankesës/raportit me nr. Nr. 2026/067, e cila është aprovuar si e bazuar, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues “Standard Home Furniture L.L.C”- Prishtinë me nr. 2026/061, të refuzohet si e pabazuar.

Lidhur me pretendimet e OE “Fatmir Godeni” B.I. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0067 kanë vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës është 2,000,000.00€. Ndërsa, kriter i dhënies së kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6, 7, 27, 56, 59, 60, dhe 62 të LPP-së. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon se AK në mënyre të kundërligjshme ka anuluar aktivitetin e prokurimit pa asnjë arsytim ligjor dhe bazë ligjore, ku me këtë rast ka bërë shkelje të nenit 62 të LPP-së, si dhe nenit 43.5 të Rregullores nr. 002/2024.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se OE ankues “Fatmir Godeni B.I.” – Prizren, ka qenë i rekomanduar për kontratë bazuar në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 17.06.2025. AK me datë 15.01.2026 ka nxjerrë Njoftimin mbi vendimin e AK-së duke e anuluar aktivitetin e prokurimit. Në këtë njoftim përmes të cilit është anuluar procedura, AK nuk ka dhënë arsytim konkret por vetëm e ka cekur se kanë ofertuar pesë OE, ndërsa asnjë operator ekonomik nuk shpërblehet me kontratë, ku sipas këtij njoftimi të gjithë OE-të kanë statusin e OE të eliminuar. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se nga përmbajtja e Njoftimit mbi Vendimin për anulim AK nuk ka dhënë arsytim konkret dhe të mbështetur në ndonjë nga bazat ligjore të përcaktuara në nenin 62 të LPP-së dhe nenit 43.5 të Rregullores nr. 002/2024 për Prokurim Publik të anulimit të aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Bazuar në Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 15.01.2026 OE ankues “Fatmir Godeni B.I.” – Prizren, është eliminuar me arsyetimin si vijim:

“Pas vlerësimit të ofertës komisioni i vlerësimit ka konstatuar se Fatmir Godeni B.I, nuk ka plotësuar kërkesën me nr.1. III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1.1. - Operatori ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për furnizime me rekuizita dhe pajisje sportive [ngjashëm me ato të kërkuara në kornizë të kësaj lënde], në shumën e përgjithshme prej 1,000,000.00 € [Një milion euro].

Në listën e kontratave dhe referencave ngjashëm me ato të kërkuara në kornizë të kësaj lënde Operatori ekonomik ka vetëm 647,374.70 € kontrata të ngjashme dhe si i tillë nuk e arrin të përmbushë kërkesën e AK. OE në fjalë nuk i plotëson kriteret e kërkuara pasi që Kontratat në listën e kontratave me numër 70,72,73,80,81,82,83,84, dhe 91 janë Renovime intervenime jashtë kërkesës dhe kategorisë së lejuar dhe kërkesës në FDT dhe Njoftimit për kontratë, në këtë formë kontratat tjera nga 1 deri në 70 janë me të vjetra se 3 vite ndërsa këto që janë paraqitur janë intervenime dhe jo furnizime sipas rekuizitave në listën e paramases.”

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se kontratat e prezantuara me ofertë si kontrata me numër rendor 72 dhe 73 janë kontrata të tëra furnizime me pajisje sportive të ngjashme të cilat janë dhe në paramase të këtij aktivitetet të prokurimi, ku vetëm me këto dy kontrata tejkalojmë kërkesën e AK-së. Tutje, OE ankues shton se kontrata me numër rendor 80, 81, 82, 83 dhe 84, AK i ka shikuar vetëm numrat e prokurimit por kontrata me numër 80 edhe numrin e prokurimit e ka furnizim pra njëjtë sikurse ky aktivitet i prokurimit pra kontratat e tjera disa e kane shërbime e disa e kane pune pasi që janë të përziera pra për kontratat e përziera që përfshijnë furnizime, shërbime dhe punë, numri i prokurimit caktohet sipas komponentës me vlerën më të lartë financiare, e cila konsiderohet objekti kryesor i kontratës njëjtë edhe në këto raste AK-te e kane përcaktuar. Ku lloji i prokurimit (dhe rrjedhimisht numri i prokurimit) përcaktohet nga: furnizimi, shërbimi ose puna që përbën pjesën dominuese financiarisht të kontratës. AK na ka diskriminuar haptas në këtë aktivitet të prokurimit pasi që jo vetëm që e kemi plotësuar kërkesën e AK-se por e kemi tejkaluar dyfish atë kërkesë. Me tej OE ankues shton se kanë bashkangjitur të gjitha kontratat dhe raportet e pranimeve teknike gjithashtu shume qarte shënon neper paramasa pasi që jemi kompania e vetme në Republikën e Kosovës që merremi me këtë lloj të aktivitetit ku i kemi lokalet dhe jemi të vetmit që e bëjmë furnizimin me pajisje sportive jo vetëm për institucione shtetërore por edhe persona tjerë juridik e privat në tere territorin e Republikës së Kosovës dhe me një fjalë jemi të vetmit të specializuar për këto lloj aktivitete ku me ndershmëri dhe profesionalizëm e kemi ngrit kompaninë tone në nivelin të cilin jemi si Kompania me profesionale dhe me e besueshme në vend për furnizim me të gjitha llojet e pajisjeve sportive. Po ashtu me kënaqësi ju ftojme që të vini për vizite në lokalet tona dhe të bindeni edhe me shume me profesionalizmin tone edhe pse ju kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme. Në baze të kontratave që i kemi prezantuar e kemi dëshmuar se neve jemi të profesionalizuar për të gjitha llojet furnizimeve, shërbimeve dhe të punëve që kane të bëjnë me pajisje sportive.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, tek kërkesa e “Kapaciteti teknik dhe professional” ka kërkuar:

Kërkesa 1.1.Operatori ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi te kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për furnizime me rekuizita dhe pajisje sportive [ngjashëm me ato të kërkuara në kornizë të kësaj lënde], në shumën e përgjithshme prej 1,000,000.00 € [Një milion euro].

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.1. - Operatori ekonomik, duhet të dorëzoj dokumentacionin si në vijim- ‘Kontratat dhe Raportet e pranimi të mallrave’, të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave përkatëse-Një [1] kopje e origjinalit. OSE-‘Certifikata Referencat e përfundimit të kontratës’, të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave përkatëse-Një [1] kopje e origjinalit. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.2.-Për të gjitha ‘Kontratat dhe Raportet e pranimi të mallrave’ DHE OSE ‘Certifikatat Referencat e përfundimit të kontratës’ të deklaruara, Operatori ekonomik, duhet të plotësoj në tërësi Tabelën nr. 1 Një [1] kopje e origjinalit.

Në lidhje me këtë kërkesë OE ankues së bashkuar me ofertë ka dorëzuar dokumentet si në vijim:

“Lista e puneve.pdf”

kontrata dhe referenca 1-3.pdf,

kontrata dhe referenca 4-6.pdf,

kontrata dhe referenca 7-9.pdf,

kontrata dhe referenca 10-14.pdf,

kontrata dhe referenca 15-19.pdf

“Kontrata dhe referenca taratam 2023 1.pdf.

Si dhe me ankesën e dorëzuar në OSHP ka bashkangjitur **“Kontratat e ndara nga Lista per OSHP”**.

Mirëpo, me rastin e shqyrtimit të pretendimit ankimor, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK gjatë vlerësimit të ofertës së OE ankues ka pranuar kontratat dhe referencat në vlerë **647,374.70€**, kurse OE ankues pretendon se nëse AK i ka anashkaluar kontratat me numër rendor 72, 73, 80, 81, 82, 83 dhe 84, ndërsa OE ankues thekson se përveç kontratave tjera të cilat AK si ka pranuar, kontrata nr. rendor 72 dhe 73 tejkalon vlerën e kërkuar së bashku me kontratat e pranuar. Në lidhje me çështjen e këtyre kontratave të cilat AK nuk i ka pranuar, **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se në ofertën e OE ankues nuk ka hasur në këto dy kontrata me nr. rendor 72 dhe 73. Andaj, vlerësoj se AK me rastin e ri vlerësimit të ofertave duhet ti kërkoj këto kontrata dhe kontratat tjera që janë në listën e kontratave, të cilat duhet ti analizoj furnizimet që janë ofruar sipas këtyre kontratave dhe të mos i paragjykoj në bazë të titullit të kontratës. Pra,

konsideroj se AK me rastin e ri vlerësimit të kërkoj sqarime shitesë sipas nenit 72 të LPP-së pasi që natyra e këtij aktiviteti të prokurimit është e ngjashme me natyrën e kontratave të prezantuara në ofertë nga OE ankues.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se AK ka shkelur të gjitha procedurat e prokurimit pasi që me datë 01.04.2025 ka qenë hapja e ofertave, ndërsa pas një viti e publikon njoftimin për anulim në kundërshtim me nenin 40.3 të Rregullores për prokurim publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të publikuar në platformën e e-prokurimit dhe shkresave të lëndës, sqaron se më datë 18.02.2025, ora 14:39, AK ka publikuar dokumentin “B04 – Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Fondeve”, ku vlera e parashikuar e kontratës është 2,000,000.00 euro. Në të njëjtën datë është publikuar edhe Njoftimi për Kontratë. Më pas, më datë 28.03.2025 dhe 02.04.2025, AK ka publikuar dokumentin B54 – Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara. Në bazë të njoftimit për kontratë, pesë (5) operatorë ekonomikë kanë dorëzuar oferta, ndërsa hapja e ofertave është bërë më 15.04.2025. Me datë 17.06.2025, AK ka publikuar B58 – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, duke e rekomanduar fitues OE ankues “Fatmir Godeni B.I”- Prizren, ndërsa më 25.06.2025 është publikuar vendimi për kthimin e lëndës në rivlerësim. Pas një periudhe pothuajse 5 muaj, më saktë me datë 15.12.2025, AK ka publikuar B58 – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke e rekomanduar fitues OE “Standard Home Furniture”. Pastaj AK me datë 15.01.2026 ka nxjerrë njoftim mbi vendimin e AK-së, dhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Duke pasur parasysh historikun e këtij aktiviteti të prokurimit, **ekspertja shqyrtuese** bazuar në këto veprime të AK-së vlerëson se AK ka ndërmarrë veprime procedurale për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, numri i madh i veprimeve të ndërmjetme, kërkesave për sqarime shitesë, njoftimeve mbi vendimet dhe kërkesave për rishqyrtim kanë zgjatur /konsumuar afate të konsiderueshme kohore. Megjithatë, periudha e pushimit apo pritjes prej muajit qershor 2025 deri në dhjetor 2025, pa ndërmarr asnjë veprim për vlerësim të ofertave, për mendimin e **ekspertes shqyrtuese** është në kundërshtim me nenin 40.3 të Rregullores Nr.002/2024. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit kanë dorëzuar ankesë pranë OSHP-së, dy (2) operatorë ekonomik, ankesa me numër të protokollit NR. 2026/061 dhe 2026/067. Sa i përket ankesës Nr. 2026/067, ekspertja shqyrtuese konsideron se ankesa është e bazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ta anuloj njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të datë 15.01.2026, dhe ta kthej lëndën në rivlerësim dhe ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tendertve të behet konform nenit 59 të LPP-së.

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa

parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me ankesën e OE “Standard Home Furniture” L.L.C, me nr. 2026/061;

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues; “Standard Home Furniture” L.L.C. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues me nr. 2026/0061 duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, vetëm për shkak të pretendimin nr. 3, sa përket stërzgjatjes së vlerësimit të ofertave, me çrast AK ka tejkaluar çdo afat ligjor të parashikuar me legjislacion, për të cilën ky Panel Shqyrtues i lëshon vërejtje zyrtarit përgjegjës të prokurimit që shkeljet e tilla ligjore në të ardhmen mos të ndodhin, në të kundërtën OSHP do t’ju drejtohet KRPP me shkrim për ndërmarrjen e masave ndaj zyrtarëve të AK. Megjithatë, pavarësisht këtij pretendimi, është e pamjaftueshme të ndryshoj epilogun përfundimtar të vendimmarrjes së AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së që aktivitetin e prokurimit të Autoritetit Kontraktues – “Ministria e Kulturës” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim (kornizë) me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës (Ri-tenderim I dyte)” me numër të prokurimit: 207-25-936-1-1-1.

Lidhur me ankesën e OE “Standard Home Furniture” L.L.C, me nr. 2026/067;

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Andaj, Paneli nuk i mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesat e operatorëve ekonomik i sheh si pjesërisht të bazuara por të pa mjaftueshme që lënda të kthehet në ri-vlerësim. Për arsye se OE ankues nuk kanë ofertuar konform kërkesave të Dosjes së Tenderit të përcaktuara nga AK.

Paneli Shqyrtues konsideron se barra e përgjegjësisë që tenderi të jetë i përgjegjshëm i takon OE në këtë rast e jo autoritetit kontraktues për të cilin ligji nuk e obligon në mënyrë të detyrueshme të kërkoj sqarime, e sidomos kur OE nuk i ka të bashkangjitura në ofertën tij/saj, kontratat për të cilat pretendon se i ka të realizuara.

Kështu që, pretendimi ankimor sa i përket eliminimit të ankuesit lidhur me arsyen e AK-së sa i përket kontratave të realizuara, Paneli Shqyrtues i jep të drejtë autoritetit kontraktues në këtë rast. Paneli Shqyrtues konsideron se duke u nisur nga kërkesa e Dosjes së Tenderit dhe kontratat e ofruara nga OE ankues, konsideron nuk është përmbushur vlera e kërkuar me Dosje të Tenderit dhe pretendimi ankimor është i pabazuar. Po ashtu, sa i përket klasifikimit të kontratave të ngjashme KRPP ka edhe opinin të publikuar në ueb faqe të platformës elektronike të e-prokurimit me dt. 22.11.2022, ku thekson se është kompetencë ekskluzive e AK një përcaktim i tillë, konkretisht i ZPP me ndihmën e njësisë së kërkesës.

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues me nr. 2026/0067 duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, vetëm për shkak të stërzgjatjes së vlerësimit të ofertave, me çrast AK ka tejkaluar çdo afat ligjor të parashikuar me legjislacion. Megjithatë, është e pamjaftueshme të ndryshoj epilogun përfundimtar të vendimmarrjes së AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së që aktivitetin e prokurimit të Autoritetit Kontraktues – “Ministria e Kulturës” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim (kornizë) me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës (Ri-tenderim I dyte)” me numër të prokurimit: 207-25-936-1-1-1.

- Përfundim -

Paneli sqaron se përveç nenit 1,6,7,27,28, 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë. Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me “kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit” për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre.

Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili ka paqartësi apo sheh ndonjë mangësi në Dosje të Tenderit apo kriter diskriminues dhe jo relevantë me natyrën e aktivitetit të prokurimit me specifikat e kërkuara DT, do duhej që në fazën paraprake, ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtroj pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK. I Njëjti po ashtu, mund të paraqes kërkesë për ri-shqyrtim/ankesë në AK/OSHP, ndërsa, jo në këtë fazë ku ankuesi i ka pranuar të gjitha kërkesa e Dosjes së Tenderit me rastin e ofertimit të tij në këtë aktivitet të prokurimit. Si rrjedhojë, të gjithë OE pjesëmarrës kërkesat e njëjta i kanë pranuar dhe për të njëjtat edhe ka ofruar ofertë, dhe nuk kanë paraqitur mangësi për përmbajtjen e DT. Kjo konfirmohet edhe me Formularin e Dorëzimit të Ofertës, ku përmes këtij formulari ka deklaruar se i ka kontrolluar dhe pranuar të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiar. E në fakte ky Formular sipas nenit 17.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimit Publik është pjesa kryesore e ofertës.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave të LPP, ku ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”.

Andaj në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të këtë procedurë të prokurimit, njëherit, sipas nenit 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të

prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji"

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - Standard Corporation L.L.C., Fatmir Godeni B.I.**
- **Arkivës së OSHP-së:**